



Data: 28.09.2020

Ref.: 1841/2020

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KShC), në mbledhjen e 82-të, të mbajtur më 02.09.2020, mori:

## V E N D I M

- I. Zgjatet periudha e akreditimit për programet e studimit të Kolegji "UBT", të cekura më poshtë për periudhën një vjeçare, 1 tetor 2020 – 30 shtator 2021:
- Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor, BSc, 180 ECTS, Prishtinë dhe Ferizaj, me specializime: 1. Arkitekturë e qëndrueshme, 2. Menaxhimi Urban, 3. Restaurimi Arkitektural, 4. Dizajn Interier, maksimum 500 student për vit akademik
  - Arkitekturë dhe Planifikim Hapësinor, BSc, 180 ECTS Prizren, me specializime: 1. Arkitekturë e qëndrueshme, 2. Menaxhimi Urban, 3. Restaurimi Arkitektural, 4. Dizajn Interier, maksimum 150 student për vit akademik
  - Inxhinieri Ndërtimore (Ndërtimtari) dhe Infrastrukturë, BSc, 180 ECTS, Prishtinë, maksimum 150 student për vit akademik
  - Inxhinieri Ndërtimore (Ndërtimtari) dhe Infrastrukturë, MSc, 120 ECTS, Prishtinë, me specializim në: 1. Inxhinieri Strukturore, 2. Menaxhim I Ndërtimtarisë dhe Teknologji, 3. Infrastrukturë Rrugore, 4. Inxhinieri e Ujërave, 5. Inxhinieri e Gjeoteknikes, 6. Inxhinieri e Materialeve, maksimum 70 student për vit akademik
  - Shkencat e Ushqimit dhe Bioteknologji, BSc, 180 ECTS, Prishtinë, me specializim në: 1. Teknologji Ushqimore, 2. Nutricion (të ushqyerit), 3. Menaxhimi dhe sigurimi I cilësisë së ushqimit, maksimum 60 student për vit akademik
  - Dizajn i Integruar, BA, 180 ECTS, Prishtinë, me specializim në: me specializime: Dizajn Industrial; Dizajn i Produkteve; Dizajn Tekstili; Dizajn Interier; Dizajn Grafik), (maksimum 50 student për vit akademik);
  - Media dhe Komunikim, BA, 180 ECTS, Prishtinë, maksimum 100 student për vit akademik
  - Shkenca Politike, BA, 180 ECTS, me specializim në: 1. Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Diplomaci, 2. Integrimi Evropiane, 3. Administratë Publike

- Sistemet e Informacionit, BA 180 ECTS, Prishtinë

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

### Arsyetimi

- I. Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC) në mbledhjen e mbajtur më 02.09.2020 ka marrë vendim për zgjatjen e periudhës së akreditimit të programeve të cekura në dispozitiv të këtij vendimi. Vendimi për zgjatje të akreditimit vlen vetëm për programet të cilat: 1. Kanë mbulueshmëri me staf akademik në harmoni me UA 15/2018, Neni 26, pika 5.3, sipas aprovimit nga KShC  
2. Institucioni i Arsimit të Lartë ka dorëzuar aplikacionin për ri-akreditim dhe raportin e vetë-vlerësimit të programit të studimit, akreditimi i së cilit mbaron me 30 Shtator 2020;  
3. Përkundër që IAL ka dorëzuar kërkesë formale për vlerësim të programit të studimit, AKA nuk ka arritur të organizoj vizitë vlerësuese me ekspert të jashtëm për programin në fjalë;
- II. KShC ka marrë këtë vendim bazuar në legjislacionin në fuqi. Sipas Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.04/L-037- datë: 29.08.2011, neni 15, Pika 3, "Riakreditimi i bartësve kryhet nga AKA-ja në intervale kohe prej jo më shumë se 5 vjetësh. Riakreditimi nuk bëhet pa një shqyrtim të raportit të vetëvlerësimit të bartësit, nga ana e ekspertëve, përveç në rrethana të veçanta. Vendimi për zgjatje të periudhës së akreditimit është marrë për shkak të rrethanave të veçanta dhe pandemisë së shkaktuar nga virusi Covid 19, e cila ka bllokuar punën normale të institucioneve dhe gjithashtu ka paralizuar për një periudhë të caktuar edhe Aeroportin e Prishtinës, duke pamundësuar kështu ardhjen e ekspertëve ndërkombëtarë.
- III. Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC) në përputhje me legjislacionin në fuqi do të monitorojë në vazhdimësi Kolegjin "UBT" me qëllim që të sigurojë se kriteret minimale të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e IAL-ve në Kosovë (Nr.9/2017, datë 02.08.2017) plotësohen në vazhdimësi për paragrafin I të këtij vendimi. Në të kundërtën KShC i AKA-së rezervon të drejtën që në njërën nga mbledhjet e radhës të veprojnë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi pasi të ketë konstatuar se ky institucion nuk ka arritur të sigurojë përmbushjen e kriterëve minimale të përcaktuara në këtë UA Nr.9/2017, datë 02.08.2017.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullosës nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit "UBT"
- MASH;
- Arkivit të AKA-së.